

RREGULLORJA E PJESËMARRËSVE NË TRAJNIMET ONLINE

- Çdo pjesëmarrës duhet të mbajë ndezur kamerën gjatë gjithë kohës së trajnimit. Prezenca juaj nëpërmjet kamerës është kriter i detyrueshëm për kualifikimin e pjesëmarrjes, e cila ndikon drejtëpërdrejtë në kualifikimin për provim/certifikim.
 - Çdo pjesëmarrës duhet të angazhohet dhe të jetë i fokusuar në trajnim (gjatë sesioneve të trajnimit nuk mund të kryejë punë të tjera njëkohësisht).
 - Çdo pjesëmarrës duhet të ketë mikrofon në kompjuter ose kufje, sepse janë grupe të vogla interaktive ku të gjithë pjesëmarrësit do të flasin.
 - Gjatë zhvillimit të trajnimit mikrofonat e pjesëmarrësve duhet të jenë të mbyllur dhe vetëm kur duan të flasin do t'i hapin, për të shmangur interferencat e zhurmave.
 - Të mos ketë largime të vazhdueshme gjatë trajnimit. Pushimet e planifikuara gjatë trajnimit online do t'ju mundësojnë një pushim të nevojshëm për të mos pasur largime të shpeshta gjatë trajnimit.
 - Pjesëmarrësit duhet të shkruajnë emrin dhe mbiemrin e plotë, sepse janë të rëndësishme për listëprezencat
 - Trajnimi duhet të ndiqet në një vend të përshtatshëm duke respektuar etikën profesionale.
- *Këto rregulla janë të domosdoshme për t'u zbatuar për të zhvilluar me sukses këtë trajnim online.

Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!